Policia jep detaje për vrasjen në Prishtinë, viktima shtetas i Maqedonisë së Veriut

15 qershor 2023, 08:35

Shpërndaje në

Policia e Kosovës ka dhënë detaje për vrasjen që ka ndodhur të mërkurën mbrëma në Prishtinë.

Sipas Policisë së Kosovës viktima është shtetas i Maqedonisë së Veriut.

Deri më tani Policia nuk ka arritur të identifikojë të dyshuarit për këtë rast. Ndërkohë që rreth një kilometër nga vendi ku ka ndodhur ngjarja është gjetur një veturë e djegur, me targa të Gjermanisë, me të cilën dyshohet se të dyshuarit për këtë rast kanë ikur nga vendi i ngjarjes.

"Raportohet se i/të dyshuar deri më tani i pa njohur kanë shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës mashkull shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore. Njësitë relevante policore kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku kanë vërejtur se në një veturë me targa të Republikës së Maqedonisë Veriore, është një person, nga mjeku përgjegjës është konstatuar se peroni i cili ishte në veturë është pa shenja jete. Rreth një kilometër nga vendi i ngjarjes është hasur një veturë e djegur me targa të Gjermanisë, me të cilën dyshohet se të dyshuarit kanë ikur nga vendi i ngjarjes", thuhet në raportin e Policisë.

Me urdhër të prokurorit të shtetit trupi i pa jetë i viktimës thuhet se është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion derisa rasti po vazhdon të hetohet.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#VRASJE #PRISHTINË

Rasti "Ukë Rugova 2", dëshmitari thotë se ka paguar rreth 3-4 mijë euro për vizë italiane
Vetura godet një këmbësor në bulevardin "Xhorxh Bush"
Arrestohet i dyshuari për dhunimin e një vajze të mitur në Lipjan
Një vajzë në Prishtinë raporton se është dhunuar nga i dashuri i saj
Theret një 26-vjeçar në Shtime
Publikoi në rrjete sociale video pornografike të të miturës, arrestohet
Vrasje në Prishtinë

Taboola Feed

Syze vetërregulluese? Quhet Power Zoom
Pagesa në dorëzim me siguri
Power Zoom | Sponsored

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Vrasje në Prishtinë
Një person është vrarë të mërkurën mbrëma në Prishtinë, i tha Policia e Kosovës KOHËS. Ngjarja ka ndodhur në "Rrugën C", derisa Policia theksoi se po i kompleton të dhënat. Laj…
Kohanet

Albania: The Cost of Solar Panels May Surprise You
Solar Panels | Search ads | Sponsored
Search Now

TË TJERA

Një muaj paraburgim për Milenkoviqin

Hetuesit e IPK-së arrestojnë një pjesëtar të Policisë, u përfshi në një rrahje në Gjakovë

Arrestohen edhe tre të dyshuar për përfshirje në krim të organizuar e skemave piramidale

Policia po heton dy raste të vdekjeve në Pejë

BALLINA LAJME ZGJEDHJET 2021 KRONIKË KULTURË MES PËR MES VËSHTRIME SPORT HOROSKOPI PODCAST VIDEO MREKULLIA

Partnerët: Shkabaj Print Kërc.

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!